

UDHËZIM
Nr.648, datë 20.3.2006

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.73, DATË 11.2.1999
“PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT, NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.1.1998 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit” i ndryshuar, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

1. Ka të drejtë të aplikojë në programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuarve të papunë çdo punëdhënës, i cili është person juridik apo fizik.

2. Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) në një periudhë njëvjeçare përpara aplikimit për programin e nxitjes së punësimit;

ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për një periudhë të paktën njëvjeçare;

iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për një periudhë njëvjeçare.

3. Për të përfutur nga ky program, punëdhënësi duhet të paraqesë pranë zyrës kompetente të punësimit të rrethit ku ai zhvillon aktivitetin, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Vendimin e gjykatës së rrethit për regjistrimin si person juridik apo fizik (në vendimin e gjykatës duhet të jetë përfshirë aktiviteti për të cilin kërkon të punësojë punëkërkuar të papunë).

b) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.

c) Informacion mbi:

i) përshkrimin e detajuar të aktivitetit që kryen;

ii) numrin e fuqisë punëtore;

iii) Listën e punëtorëve të punësuar dhe të siguruar para aplikimit për përfitim për programe nxitje punësimi;

iv) nivelin e pagës që ai ka dhënë për çdo person.

ç) Vërtetim për kontributet e paguara për sigurimet shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin, që lëshohen nga organi tatimor përkatës.

d) Vërtetim për periudhën pararendëse (për të paktën 1 vit) për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe numrin e personave të siguruar, të lëshuar nga organet e sigurimeve shoqërore.

dh) Numrin e llogarisë bankare.

e) Një informacion mbi:

i) numrin e punëtorëve që kërkohen të punësohen,

ii) profesionin për të cilin do të punësohen,

iii) përshkrimin e aktivitetit që do të kryejnë këta punëtorë,

iv) kohëzgjatjen e punësimit,

v) llojin e kontratës që kërkon të zbatojë,

vi) nivelin e pagës.

ë) Një plan biznesi ku të jetë e justifikuar rritja e menjëhershme e fuqisë punëtore dhe kushtet e punës, pajisjeve dhe ambienteve.

f) Vërtetim nga dega e tatim-taksave e rrethit ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për periudhën njëvjeçare pararendëse, si dhe periudhën e vitit në vazhdim deri në momentin që aplikon për program nxitje punësimi.

Me të dhënat e dokumentacionit të mësipërm, punëdhënësi në bashkëpunim me zyrën kompetente të punësimit, plotëson formularin përkatës.

4. Inspektori i Inspektoratit Rajonal dhe Vendor të Punës bën verifikimin e dokumentacionit të

paraqitur nga subjekti sipas germave “c” dhe “e” dhe shprehet brenda 7 ditëve mbi vërtetësinë e këtij dokumentacioni, si dhe korrektësinë e subjektit ndaj legjislacionit të punës. Marrëdhëniet midis tyre rregullohen me urdhrin nr.418, datë 25.2.2004 të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Zyra kompetente e punësimit shpall në media çdo fillim viti numrin e projekteve që do të financojë sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri. Vetëm në rastet kur për një projekt ka të paktën tre aplikues zyra e punësimit ia paraqet ato Këshillit Lokal Tripalësh, i cili shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.

6. Pas miratimit në parim të projekteve në Këshillin Lokal Tripalësh zyra kompetente e punësimit i rendit aplikimet sipas prioriteteve të vendosura nga Ministri dhe i dërgon për miratim si më poshtë:

a) Zyra vendore e punësimit dërgon për miratim të gjitha projektet, sipas rastit në zyrën rajonale të punësimit ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

b) Zyra rajonale e punësimit miraton projektet, kur aplikues janë ndërmarrjet e vogla në kuptim të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” dhe dërgon për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit projektet ku aplikues janë ndërmarrjet që kanë mbi 21 të punësuar.

Sipas ligjit të sipërpërmendur:

I. Ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 6-20 punonjës;
b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 40 milionë lekë;
c) 100 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të ligjit të sipërpërmendur, klasifikohen si ndërmarrje të vogla.

II. Ndërmarrjet e mesme janë ndërmarrjet të cilat:

a) punësojnë 21-80 punonjës;
b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 80 milionë lekë;
c) më pak se 25 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të ligjit të sipërpërmendur, nuk klasifikohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

7. Në rastet kur aplikues janë ndërmarrje të vogla në kuptimin e numrit të punonjësve, por me përfitimin e financimit sipas këtij programi hyjnë te ndërmarrjet e mesme, aplikimi dërgohet për miratim në komisionin e ngritur në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

8. Mënyra e vlerësimit të projekteve nga komisionet përcaktohet në një rregullore të miratuar nga Këshilli Administrativ Tripalësh i SHKP-së.

9. Për zbatimin e pikës 6 të këtij udhëzimi ngrihen komisionet përkatëse për miratimin e projekteve dhe konkretisht:

a) Në çdo zyrë rajonale punësimi ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.
b) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit ngrihet komisioni i miratimit të projekteve.

Mënyra e funksionimit e metodikës së punës dhe përbërjes së komisioneve përcaktohet me rregullore të veçantë të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

10. Komisioni i zyrës rajonale të punësimit vendos për miratimin ose jo të projektit brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim nga punëdhënësi. Komisioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendos për miratimin ose jo të projektit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes për aplikim nga punëdhënësi.

11. Për projektet e miratuara zyra kompetente e punësimit, në bashkëpunim me punëdhënësin, plotësojnë listën e punëkërkuësve të papunë që do të përfshihen në program. Punëkërkuësit e papunë që përfshihen në program duhet të jenë të regjistruar në zyrat e punësimit për një periudhë të paktën tre mujore.

Ndërmjet zyrave kompetente të punësimit dhe punëdhënësit nënshkruhet një kontratë ku përfshihen të drejtat dhe detyrat që përcakton programi për secilën palë. Kontratat e lidhura ndërmjet punëdhënësit dhe zyrave kompetente të punësimit janë të vlefshme vetëm për vitin kalendarik.

Në rastet kur financimi vazhdon për vitin pasardhës, shtesa përkatëse në kontratë bëhet pasi kryhet një vlerësim për zbatimin e projektit me kontratën e parë.

12. Në zbatim të pikës 1 të vendimit për çdo punëkërkuës të përfshirë në program punëdhënësi përfiton:

a) Kompensim mujor për pagë në masën 100% të pagës minimale për një periudhë deri në 6

muaj me përjashtim të programeve që zbatohen në fushën e industrisë minerale, nxjerrëse dhe përpunuese ku kohëzgjatja mund të jetë deri në 9 muaj.

b) Kompensim mujor për sigurimet shoqërore e shëndetësore në masën 100% për një periudhë 6-mujore, me përjashtim të programeve që zbatohen në fushën e industrisë minerale, nxjerrëse dhe përpunuese ku kohëzgjatja mund të jetë deri në 9 muaj, duke iu referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

13. Në zbatim të pikës 2 të vendimit, pas përfundimit të periudhës së formimit për çdo të punësuar mbi numrin e fiksuar në kontratë, punëdhënësi merr një shpërblim të menjëhershëm të barabartë me 100% të shumës së pagës minimale në shkallë vendi dhe 100% të shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore për punëmarrësit për një periudhë 3-mujore.

14. Financimi ndaj subjektit bëhet duke iu referuar nivelit të pagës minimale në shkallë vendi, për efekt të zbatimit të këtij vendimi.

15. Marrëdhëniet midis zyrave kompetente të punësimit, punëdhënësit dhe punëkërkuësve të papunë të punësuar sipas këtij programi, vendosen në marrëveshje të përbashkëta midis tyre. Punëdhënësi dhe punëmarrësi nënshkruajnë një kontratë për kushtet e punësimit të personave që punësohen. Kontrata përmban në çdo rast emrat e të gjithë personave që do të angazhohen në program.

16. Në rastet ku punëmarrësit e punësuar sipas këtij programi largohen përpara afatit të kontratës, punëdhënësi duhet të bëjë njoftim në zyrën e punësimit. Punëmarrësit e larguar nuk zëvendësohen.

17. Me kërkesë të Inspektoratit Shtetëror të Punës apo të strukturave të kontrollit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit punëdhënësit i ndërpriten financimi kur bën pushime, pa shkaqe të arsyeshme të punëmarrësve të tjerë jashtë këtij programi.

18. Në zbatim të pikës 3 të vendimit zyra kompetente e punësimit është e detyruar të çregjistrojë nga lista e punëkërkuësve të papunë personat që pa arsye të pranueshme refuzojnë të marrin pjesë në program. Procedurat përcaktohen në rregulloren përkatëse të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

19. Në zbatim të pikës 4 të vendimit, zyra kompetente e punësimit plotëson listën e personave të përfshirë në program të cilët janë përfitues të pagesës së papunësisë. Zyra kompetente e punësimit llogarit nëpërmjet kësaj liste fondet e kursyera nga ai program të cilat i kalojnë masën 100% buxhetit të këtij programi.

20. Në zbatim të pikës 5 të vendimit, zyra kompetente e punësimit plotëson listën e personave të punësuar që janë pjesëtarë të familjeve përfituese të programit të ndihmës ekonomike. Zyra kompetente e punësimit llogarit nëpërmjet këtij formulari sasinë e fondeve që përfiton ky program nga punësimi i tyre. Kjo sasi është 40% e ndihmës ekonomike të plotë për një familje me 4 persona për çdo muaj trajnim.

21. Zyra kompetente e punësimit përpilon dhe dërgon çdo muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, informacion në lidhje me zbatimin e projekteve, personat e punësuar, përfituesit e programeve të mbështetjes me të ardhura, punëkërkuësit e papunë etj.

22. Për përparësitë dhe fushat prioritare ku do të zbatohet programi, të zbatohet urdhri i nxjerrë çdo fillim viti nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

23. Procedurat e mëtejshme për përdorimin e fondeve të nxitjes së punësimit përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Financave nr.1, datë 5.2.2001 “Për kriteret dhe procedurat e subvencionimit për të nxitur punësimin”.

24. Procedurat për zbatimin e këtij programi, formularët tip, kontratat tip, marrëveshjet tip përcaktohen me rregulloren metodike të zbatimit të Këshillit Administrativ Tripalësh të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Kontratat dhe marrëveshjet tip të shërbejnë vetëm si udhëzues për punonjësit e zyrave të punësimit, ndërkohë që ato duhet të rishkruhen për çdo rast lidhje kontrate me subjekte të ndryshme.

25. Udhëzimi nr.73, datë 14.1.2004 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOÇO BARKA
MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA